

Siguri

Postoi foto me armë në Facebook, 25-vjeçari në Deçan përfundon nën hetim nga Policia



Sinjali.com

09 Korrik 2026 08:51



Një fotografi e publikuar në rrjetet sociale ka vënë në lëvizje Policinë e Kosovës, e cila ka identifikuar dhe intervistuar një 25-vjeçar nga Deçani, nën dyshimin për armëmbajtje të paautorizuar, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se Stacioni Policor në Deçan ka pranuar informacione se Hajdar Tahiraj (25-vjeç) kishte publikuar në Facebook fotografi ku shfaqej me një armë në dorë.

Pas verifikimeve, i dyshuari është identifikuar dhe është paraqitur në stacionin policor, ku është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës.

Sipas burimeve, gjatë deklaramit të tij, Tahiraj ka thënë se fotografia ishte realizuar në vitin 2023, në Bjeshkën e Baballoqit, gjatë një shëtitjeje të organizuar. Ai ka deklaruar se arma nuk ishte e tij, por i përkiste një personi të panjohur, duke shtuar se në atë aktivitet kishin qenë të pranishëm shumë persona.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se, me urdhër të Prokurorit kujdestar të Prokurorisë Themelore në Pejë, ndaj tij është iniciuar procedurë për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Pas intervistimit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet vazhdojnë për të verifikuar rrethanat e plota të rastit dhe identitetin e personit që, sipas deklaramit të tij, kishte në pronësi armën e shfaqur në fotografi.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera